



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr. 2576/2 Prot

Rrëshen, më 23 . 06 . 2026

V E N D I M

Nr. 51 datë 22. 06. 2026

P Ë R

**“MIRATIMIN, PËRDORIM FOND EMERGJENCAVE CIVILE
NGA BUXHETI I VITIT 2026”, BASHKIA MIRDITË**

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligji nr. 9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ligji nr. 68/2017, “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligji nr. 45/2019, “Për mbrojtjen civile”, ligji nr. 87/2025, “Për buxhetin e vitit 2026”, Udhëzimin nr. 9, datë 20. 07. 2018, i Ministrisë Financave dhe Ekonomisë, “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, Udhëzimin nr. 2, datë 14.01.2026, “Për zbatimin e buxhetit 2026”, Vendimin nr. 98, datë 10.12.2025, të Këshillit Bashkiak Mirditë, “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026”, *Relacion për përdorim fond emergjencave civile nga buxheti i bashkisë, nr. 2576 prot, datë 08.06.2026 dhe preventivi i objektit, së bashku me projekt-vendimin e paraqitur nga Kryetari i Bashkisë, pas shqyrtimit dhe miratimit, në mbledhjen e datës 19.06.2026, të Komisionit të Ekonomisë, Financave dhe Buxhetit, për t’ia kaluar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak, pas diskutimeve;*

V E N D O S I:

1. Të miratojë përdorim fond emergjencave civile nga buxheti i vitit 2026, si më poshtë;
 - a) **Paksim** fondi në zërin e buxhetit “fond i emergjencave civile”: me kodet e buxhetitsi më poshtë;
133 00 2133001 01 231 AC133 V091AAB;.....2 119 749 lekë
 - b) **Shtesë** fondi në zërin e buxhetit: Rikonstruksion i Urës Metalike në Lagjen e Re, pranë Gurit të Kishës njësia administrative Rubik, në kodet e buxhetit si vijon;
133 00 2133001 01 231 AA133 V091AAB;.....2 119 749 lekë
2. Relacioni për përdorim fond emergjencave civile nga buxheti i bashkisë, nr. 2576 prot, datë 08.06.2026 dhe preventivi, bashkëlidhur, pjesë përbërse e këtij vendimi
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë; (Drejtoria Juridike, Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Drejtoria e Financë dhe Buxhetit & AIKE)

Ky vendim, hyn në fuqi, sipas përcaktimeve të pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr.139/2015, “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, dhe pas konfirmimit ligjor, nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

SEKRETAR
Gaspër TOPOLLAJ

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al



KRYETAR
Aleksandër PICAËU

www.bashkiamirdite.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPERISE

BASHKIA MIRDITË

KËSHILLI I BASHKISË MIRDITË

P/V E N D I M

Nr. 60 date 16.06.2026

Nr. 2576 / prot
1

Rreshen me 16 / 06 /2026

“PËR PËRDORIM FOND EMERGJENCAVE CIVILE, BUXHET BASHKIE”

Mbështetur në ligjit 139/2015 " Për vetëqeverisjen vendore", në ligjin Nr. 9936 date 26.06.2008 “ Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, ne ligjin nr. 68/2017 “Për financat e vetëqeverisjes vendore”, ligji nr.45/2019 “Per mbrojtjen civile”, 87/2025, “Per buxhetin e vitit 2026”, “Udhëzimin Nr.9 datë 20.07.2018 “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit”, në udhëzimin nr.2, datë.14.01.2026, “Për zbatimin e buxhetit 2026”, ne VKB nr.98 datë 10.12.2025 “Për miratimin e buxhetit të vitit 2026”, relacionin nr.2576 prot, date 08.06.2026, e sektorit te emergjencave civile, preventivin e DPZHT date.16.06.2026 , Këshilli i Bashkisë Mirditë, pasi diskutoi rreth projektit të paraqitur nga Kryetari i Bashkisë;

V E N D O S I:

1. Të miratojë perdorimin nga fondi i emergjencave civile,(buxheti I bashkise) si me poshte.:

a-Paksim zerin e buxheti “fondit te emergjencave civile(buxheti I bashkise)”,me kodet e buxhetit si me poshte:

133 00 2133001 01 231 AC133 V091AAB.....2 119 749 leke

b-Shtese fondi ne zerin e buxhetit: “Rikonstruksion i ures metalike, ne lagjen e re, prane gurit te kishes”, NJA Rubik, ne kodet e buxhetit si me poshte:

133 00 2133001 01 231 AC133 V091AAB..... 2 119 749 leke

ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRESHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 222162223www.bashkiamirdite.gov.a

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkise

Ky vendim hyn në fuqi sipas përcaktimeve të pikës 6 të nenit 55 të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar dhe pas konfirmimit ligjor nga Institucioni i Prefektit të Qarkut Lezhë.

SEKRETARI

KRYETARI

Gaspër TOPOLLAJ

Aleksander PICA KU

Paraqiten projektin

Dr. AIKE: F.Vorfi

Dr./zhvill ek dhe tatim taksat:: V.Gjoka

Pergj sekt juridik/prok: L.Gjergji

Dr,PZHT: J . Tusha

KRYETARI

Albert MËLYSHI



ADRESA: SHESH "ABAT DOÇI", RRESHEN

email: bashkia@bashkiamirdite.gov.al tel dhe fax : (00355) (0) 222162223 www.bashkiamirdite.gov.a



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MIRDITË

Nr. 2576 Prot.

Rrëshen, me 08/08/2026

RELACION

PËR PROJEKT-VENDIMIN PËR PËRDORIM FONDI EMERGJENCA CIVILE, BUXHET
BASHKIE.

Drejtuar : Këshillit të Bashkisë Mirditë

Të nderuar këshilltarë,

Bazuar në ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” ligjit 45/2019 “Për mbrojtjen civile”, Vkm nr. 414, datë 8.7.2021”Për miratimin e procedurave dhe kritereve të ndarjes dhe të përdorimit të fondit të kushtëzuar të buxhetit të shtetit për mbrojtjen civile”, mbi marrjen e masave parandaluese, lehtësuese, mbrojtëse dhe rehabilituese në objektet infrastrukturore që përbëjnë një kërcënim serioz për jetën e njerëzve, pronat e tyre dhe mjedisin, të cilat ndikojnë në rikthimin e jetës normale për komunitetin e veprimtaritë e tij ekonomike, kërkojmë miratimin e këtij projekt – vendimi për ndërhyrje emergjente në urën metalike në lagjen e re, pranë Gurit të Kishës, Njësia Administrative Rubik, Bashkia Mirditë.

Nga verifikimi mbi gjendjen teknike të urës metalike, me qëllim evidentimin e problematikave strukturore, vlerësimin e nivelit të degradimit dhe përcaktimin e nevojës për ndërhyrje emergjente. Gjatë inspektimit u konstatua se objekti paraqet dëmtime të konsiderueshme konstruktive si pasojë e amortizimit shumëvjeçar, korrozionit të avancuar të elementëve metalikë, mungesës së mirëmbajtjes periodike dhe ekspozimit të vazhdueshëm ndaj faktorëve atmosferikë.

Kjo structure rezulton në gjendje të avancuar degradimi pasi në të gjithë gjatësinë e urës konstatohet prani e korrozionit të avancuar në elementët mbajtës. Gjithashtu janë evidentuar humbje pothuajse e plotë e shtresës mbrojtëse të bojës, deformime lokale të profileve metalike dhe humbje e pjesshme e seksioneve në zona të korroduara;

Për shkak të degradimit shumëvjeçar, një pjesë e elementëve nuk garanton më parametrat fillestarë të projektimit pasi konstatohen mungesë e elementëve të kalimit (dërrasa) dhe mungesë e kushteve minimale të sigurisë për lëvizjen e personave. Bazuar në gjendjen e konstatuar, vlerësohet se objekti ndodhet në kushte të avancuara degradimi teknik, dhe ndërhyrja konsiderohet emergjente dhe e domosdoshme për garantimin e sigurisë strukturore dhe funksionale të objektit.

Me qëllim rikthimin e përdorimit të kësaj ure për banorës e zonës, kërkohet zëvendësimi i profileve metalike, riparimi i elementëve diagonalë dhe nyjeve lidhëse, rikonstruksioni i platformës së kalimit ku është e nevojshme, zëvendësimi i parmakëve dhe elementëve mbrojtës dhe vendosje sinjalistike dhe ndriçimi. Kjo urë do shërbejë për kalimin e lagjes Paraspurë, pasi, nga Autoriteti Rrugor Shqipëtar po vijon puna për demontimin dhe rindërtimin e urës automobilistike, dalë jashtë funksionit si rezultat i dëmtimit strukturor.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

Hartuan relacionin:

Përgj. Sektori EC: Ilir GJINI

Drejtori AIKE: Frederik VORFI



ADRESA: SHESHI “ABAT DOÇI”, RRËSHEN

email:bashkia@bashkiamirdite.gov.al

tel dhe fax : (00355) (0) 2162233

www.bashkiamirdite.gov.al

MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISË
ALBERT MELYSHI



Projektuesi: Daisler PEPA

Objekti: Rikonstruksion i Ures Metalike ne Lagjen e Re Prane Gurit te Kishes

Datë:

PREVENTIV

NR	KODI	EMËRTIMI I PUNIMEVE	NJËSIA	SASIA	ÇMIMI	VLEFTA
		0. PRODHIMI I MATERIALEVE TE NDERTIMIT				
1	1.105/p	Pergatitje kapriata metalike me profile	ton	5.0	215,381.49	1,076,907.45
Shuma 1:						1,076,907.47
		1. PUNIME HEKUR BETONI				
2	2.183/1	Saldim profila metalike	copë	20.0	262.50	5,250.00
	F	F. Lllamarine e zeze e riguar	KG	5880	110.00	646,800.00
Shuma 2:						652,050.00
		3. ANALIZA JASHTË LISTE				
4	AnAn456 654an	Vida betoni	copë	2500.0	15.00	37,500.00
Shuma 3:						37,500.00
SHUMA 1+2+3						1,766,457.47
TVSH 20%						353,291
Totali						2,119,748.964

Preventivnesi:

Daisler PEPA

Shënime:

Çmimet u moren nga manuali e-albania date 16/06/2026